

Në bazë të nenit 75 paragrafit (5), nenit 138 paragrafit (16) dhe nenit 146 paragrafit (3) të Ligjit për Asimin Fillor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 161/19, 229/20, 3/25, 74/25, 250/25 dhe 111/26), ministrja e Arsimit dhe Shkencës, solli

RREGULLORE
PËR MËNYRËN E PËRCAKTIMIT TË SUKSESIT TË PËRGJITHSHËM TË NXËNËSIT
DHE TË NOTËS SË SJELLJES, DHËNIEN E PROVIMIT KLASOR, PROVIMIT PËRMIRËSUES
DHE PROVIMEVE PËR PËRPARIM MË TË SHPEJTË TË NXËNËSIT, SI DHE DHËNIEN E
LËVDATEVE DHE SHPËRBLIMEVE PËR NXËNËSIT

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e përcaktimit të suksesit të përgjithshëm të nxënësit dhe notës së sjelljes, dhënia e provimit klasor, provimit përmirësues dhe provimeve për përpërparim më të shpejtë të nxënësit, si dhe mënyra e dhënies së lëvdatave dhe shpërblimeve për nxënësit në shkollën fillore.

Neni 2

Suksesi i përgjithshëm i nxënësit dhe nota e sjelljes përcaktohen në bazë të ndjekjes së vazhdueshme, sistematike, objektive dhe publike, kontrollit dhe vlerësimit të përpërparimit të nxënësit, në përputhje me standardet për vlerësimin e përcaktuar në programet mësimore, si dhe në bazë të qëndrimit të tij ndaj mësimin, përmbushjes së detyrimeve shkollore dhe respektimit të rregullave të shkollës.

Neni 3

Suksesi i përgjithshëm i nxënësit përcaktohet në bazë të notave vjetore nga të gjitha lëndët sipas planit mësimor në fund të vitit shkollor, ndërsa për nxënësit dërguar në provim klasor ose provim përmirësues, pas përfundimit të provimeve.

Suksesi i përgjithshëm i nxënësit përcaktohet në bazë të notës e cila paraqet mesataren aritmetike të notave pozitive në lëndët mësimore, edhe atë:

- nxënësi ka arritur sukses të shkëlqyer nëse ka notë mesatare nga 4,50 deri në 5,00;
- nxënësi ka arritur sukses shumë të mirë nëse ka notë mesatare nga 3,50 deri në 4,49;
- nxënësi ka arritur sukses të mirë nëse ka notë mesatare nga 2,50 deri në 3,49; dhe
- nxënësi ka arritur sukses të mjaftueshëm nëse ka notë mesatare nga 2,00 deri në 2,49.

Neni 4

Nxënësi vlerësohet edhe me notë për sjelljen.

Notat e sjelljes janë: shembullore, e mirë dhe e pakënaqshme.

Neni 5

Me notën e sjelljes përfshihet qëndrimi i nxënësit në procesin edukativo-arsimor, respektimi i detyrimeve në shkollën fillore dhe në bashkësinë e paraleles, qëndrimi ndaj bashkënxënësve të tyre, mësimdhënësve, pronave të shkollës dhe vlerat e tjera pozitive.

Notën e sjelljes për nxënësit e klasave I–V e përcakton mësimdhënësi i grupit klasor, ndërsa për nxënësit e klasave VI–IX e përcakton këshilli i mësimdhënësve, me propozim të udhëheqësit të klasës.

Neni 6

Nota e sjelljes përcaktohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit shkollor.

Neni 7

Notat gjatë dhe në fund të gjysmëvjetorit të parë, përkatësisht të dytë, regjistrohen në evidencën dhe dokumentacionin pedagogjik.

Neni 8

Provimet klasore, provimet përmirësuese dhe provimet për përpërparim më të shpejtë jepen në shkollën fillore të ciln e ndjek nxënësi.

Neni 9

Nxënësi i cili duhet të japë provim klasor dhe provime për përparim më të shpejtë, përkatësisht prindi/kujdestari i tij paraqet kërkesë me shkrim në shkollën fillore.

Në kërkesë nxënësi, përkatësisht prindi/kujdestari i tij e shënon klasën dhe lëndët të cilat duhet t'i japë në provim.

Neni 10

Provimet klasore, përmirësuese dhe provimet për përparim më të shpejtë organizohen dhe realizohen në përputhje me programet mësimore dhe standardet e vlerësimit.

Neni 11

Provimet klasore, përmirësuese dhe provimet për përparim më të shpejtë jepen para komisionit provues të shkollës fillore.

Komisioni provues përbëhet nga kryetar, anëtar dhe anëtar-provues nga lënda përkatëse. Komisioni provues punon në përbërje të plotë.

Neni 12

Provimet mund të jepen:

- me gojë;
- me shkrim dhe me gojë; dhe
- me shkrim.

Shkolla përcakton mënyrën e dhënies së provimeve për lëndët e veçanta në përputhje me mënyrën e vlerësimit të lëndës mësimore.

Neni 13

Pjesën me gojë të provimit nxënësi e jep duke tërhequr pyetje, duke u kujdesur që me to të përfshihen të gjitha pjesët e programit mësimor.

Pjesën me shkrim të provimit e përgatisin, kontrollojnë dhe vlerësojnë anëtarët e komisionit të provimit. Nota detyrimisht duhet të jetë e arsyetuar.

Nxënësi mund ta japë pjesën me gojë të provimit pavarësisht suksesit që ka treguar në pjesën me shkrim.

Neni 14

Pas përfundimit të provimit, komisioni i provimit e përcakton notën nëse për të janë deklaruar të paktën dy anëtarë të komisionit.

Anëtari i komisionit i cili nuk pajtohet me notën, mund të kërkojë që mendimi i tij i veçantë të shënohet në procesverbal.

Neni 15

Gjatë përcaktimit të notës në lëndë të caktuar merret parasysh sukcesi i treguar si në pjesën me shkrim ashtu edhe në atë me gojë, nëse zhvillohen të dyja pjesët.

Neni 16

Komisioni i provimit është i detyruar të sigurojë që provimi të realizohet pa pengesa dhe në mënyrë të pavarur.

Neni 17

Provimet klasore dhe përmirësuese realizohen në dy afate provimi, në qershor dhe gusht të vitit vijues.

Nxënësi ka të drejtë që provimin e klasës ose provimin përmirësues ta japë një herë në secilin nga afatet e provimeve.

Nxënësi mund të japë më së shumti dy lëndë në një ditë.

Nëse nxënësi nuk merr notë pozitive në lëndët, përkatësisht lëndët sipas të cilëve ka dhënë provimin, konsiderohet se nuk e ka përfunduar klasën dhe ka përsëritur të njëjtën klasë.

Për nxënësin që jep provim klasor ose provim përmirësues, shkolla siguron mbështetje mentorale dhe konsultative nga mësimmhënësi i lëndëve përkatëse.

Orari i dhënies së provimeve publikohet në tabelën e njoftimeve dhe/ose në ueb-faqen e shkollës të paktën tre ditë para ditës së caktuar për dhënien e provimeve.

Neni 18

Nxënësi i cili ka të drejtë për përparim të përshpejtuar mund të japë provime për përparim të përshpejtuar me kërkesë të tij, përkatësisht me kërkesë të prindit/kujdestarit të tij dhe në bazë të vendimit të Këshillit të Mësimdhënësve, në përputhje me ligjin.

Nëse kërkesa për përparim të përshpejtuar është paraqitur dhe vendimi është sjellur deri në fund të vitit shkollor, provimet për përparim të përshpejtuar jepen në afatet e rregullta të provimeve në qershor dhe gusht. Pas dhënies me sukses të provimeve, nxënësi në vitin shkollor vijues vazhdon ta ndjek mësimin në klasën në të cilën përparon.

Nëse gjatë vitit shkollor Këshilli i Mësimdhënësve sjell vendim për përparim të përshpejtuar të nxënësit, shkolla organizon sesione të jashtëzakonshme të provimeve për dhënien e provimeve për përparim të përshpejtuar.

Provimet nga paragrafi (3) i këtij neni organizohen në mënyrë që të mos pengojnë ndjekjen e rregullt të mësimit nga ana e nxënësit.

Pas dhënies me sukses të provimeve nga paragrafi 3 i këtij neni, nxënësi menjëherë vazhdon mësimin në klasën në të cilën përparon.

Nxënësit i cili ka përparuar sipas paragrafit 3 të këtij neni, pas përfundimit të vitit shkollor i lëshohet dëftesë për klasën në të cilën e ka ndjekur rregullisht dhe dëftesën për klasën për të cilën i ka dhënë provimet për përparim të përshpejtuar.

Shkolla është e obliguar të sigurojë mbështetje pedagogjike, profesionale dhe organizative për nxënësin me qëllim të përfshirjes së pandërprerë në procesin edukativo-arsimor në klasën në të cilën përparon.

Neni 19

Lavdërimet dhe shpërblimet mund t'u jepen nxënësit, grupit të nxënësve, seksionit, ekipit dhe paraleles, gjatë dhe në fund të vitit shkollor.

Neni 20

Nxënësi mund të lavdërohet dhe shpërblehet veçanërisht për:

- suksesin dhe përparimin në mësim,
- pjesëmarrjen dhe rezultatet e arritura në aktivitete jashtëmësimore, gara, konkurse, ekspozita dhe aktivitete të tjera,
- sjelljen shembullore, shoqërinë e mirë, empatinë, respektin dhe ndihmën ndaj nxënësve të tjerë, angazhimin dhe
- kontributin në aktivitetet e shkollës dhe të komunitetit lokal, veçanërisht në aktivitete humanitare, kulturore, ekologjike dhe shoqërisht të dobishme.

Neni 21

Lavdërimet dhe shpërblimet u jepen edhe:

- paraleles që dallohet veçanërisht për suksesin, sjelljen dhe rregullsinë në përmbushjen e detyrimeve shkollore;
- grupit, seksionit ose ekipit i cili ka arritur rezultate të veçanta (vendin e parë, të dytë ose të tretë etj.) në gara;
- paraleles, grupit, dhe seksionit i cili ka që arrin rezultatet më të mira në aktivitet të caktuar të organizuar në shkollë ose jashtë saj (prodhues, humanitar, kulturor dhe aktivitete të tjera).

Neni 22

Propozim për ndarjen e lavdërimeve dhe shpërblimeve mund të paraqes mësimdhënësi i klasës, udhëheqësi i klasës, mësimdhënësi lëndor, shërbimi profesional, komisioni i shkollës, Këshilli i klasës ose Këshilli i mësimdhënësve.

Propozimi nga paragrafi (1) i këtij neni përmban arsyetim për rezultatet e arritura, sjelljen, angazhimin dhe kontributin e nxënësit, grupit, seksionit, ekipit ose paraleleve.

Neni 23

Vendim për dhënien e lavdërimeve dhe shpërblimeve sjell Këshilli i klasës, përkatësisht Këshilli i mësimdhënësve.

Lavdërimet dhe shpërblimet jepen gjatë vitit shkollor ose në fund të vitit shkollor.

Neni 24

Lavdërimet mund të ndahen me gojë ose me shkrim.

Lavdërimet me shkrim jepen në formë të fletëlavdërimeve, diplomave dhe mirënjohjeve. Shpërblimet jepen në përputhje me qëllimin e tyre edukativo-arsimor dhe pedagogjike.

Neni 25

Fletëlavdërimet, diplomat dhe mirënjohjet i nënshkruan drejtori i shkollës.

Për rezultatet e arritura në gara komunale, rajonale, shtetërore dhe ndërkombëtare, shkolla mund të ndajë fletëlavdërim ose shpërblim të veçantë.

Neni 26

Lavdërimet dhe shpërblimet ndahen në mënyrë solemne, me qëllim të nxitjes së motivimit, suksesit, kreativitetit, përgjegjësisë dhe sjelljes pozitive të nxënësit.

Ndarja e lavdërimeve dhe shpërblimeve mund të organizohet në ditën e patronatit të shkollës, në shfaqje solemne, në manifestimin përmbyllës, në ekspozitë, në prezantim publik ose në ndonjë aktivitet tjetër të organizuar nga shkolla.

Shkolla mund t'i promovojë publikisht rezultatet e arritura të nxënësve përmes tabelës së shpalljeve, ueb faqen e internetit të shkollës, publikimeve shkollore dhe formave të tjera të informimit, në përputhje me rregulloret për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 27

Për lavdërimet dhe shpërblimet e dhëna, shkolla mban evidencë në dokumentacionin pedagogjik.

Neni 28

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme pas ditës së sjelljes së saj.

Nr. 12-8751/1

01.07.2026

Shkup

Ministre e Arsimit dhe Shkencës,

д-р Весна Јаневска, д.в.